

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

### Qartësia<sup>1</sup> / *el-Besirah* / البصيرة

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

لِ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُو إِلَى اللَّهِ عَلَىٰ بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي

“Thuaj: ‘Kjo është rruga ime. Ftoj për te Allahu me qartësi; unë dhe ata që më ndjekin.’” (Jusuf, 108)

Qartësia është ajo që ta largon hutimin<sup>2</sup>. Kjo ka tri nivele:

<sup>1</sup> *Besirah* vjen nga *besar* (të parë). Kjo është të parët e zemrës përtej sipërfaqes së jashtme.

<sup>2</sup> Sipas Ibn el-Kajjim, kjo është drita që Allahu fut në zemrat e robërve, duke ua mundësuar kështu ta shohin, me shikimin e zemrës, të vërtetën që u qe shpallur të Dërguarve. Po ashtu thuhet se ky mund të jetë një realizim i thellë i fjalëve të Allahut, që nuk kufizohet ose nuk mbulohet nga të jashtmet e materialeve përreth nesh. Allahu ﷻ tha:

“Fjala e Zotit tënd u përmbush me vërtetësi dhe drejtësi. Askush s’mund t’i ndryshojë fjalët e Tij. Ai dëgjon gjithçka, sheh gjithçka.” (el-En’am, 115)

Të gjitha thëniet e Tija janë të vërteta dhe të gjithë urdhrat e Tij janë të drejtë, me vend, dhe bëhen për një qëllim të caktuar.

1. Thëniet e Tij përfshijnë shpalljet e Tij për veten e Tij, për të padukshmen, për njeriun dhe universin, si edhe për premtimet dhe kërcënimet e Tij. Pranimi i plotë i këtyre ndërsa respektohet epërsia e Tij është mënyra e arritjes së qartësisë (*besires*) në këto rrafshje.
2. Urdhrat e Tij përfshijnë krijimin e Tij, kontrollin e Tij të vazhdueshëm të rendit universal, dhe instruksionet e Tij. Mënyra e arritjes së qartësisë (*besiras*) në këto rrafshje është nënshtrimi i plotë ndaj ligjeve të Tij, siç u shpjeguan nga i pagabueshmi ﷻ dhe siç u zbatuan në praktikë nga Gjeneratat e Drejta; pranimi i plotë i vendimeve të Tij, dhe hulumtimi i vyer në krijimin e Tij (përfshirë dhe analizën e vetvetes). Një hulumtim i këtitillë nuk është i kufizuar

Niveli i parë është t'i dish instruksionet e përcjella nga burimet e padiskutueshme sheriatike dhe pasojat e garantuara (për mosrespektim). Kështu, ti përmbush këto të drejta duke i kryer me kënaqësi dhe duke i mbrojtur me mish e me shpirt.<sup>3</sup>

Niveli i dytë është:

- Të parët e drejtësisë në udhëzimin dhe devijimin që bën i Vërteti<sup>4</sup>
- Të parët e hirit të Tij në shpërndarjen që bën Ai<sup>5</sup>
- Të parët e miqësisë së Tij në tërheqjen që ta bën Ai<sup>6</sup>

Niveli i tretë është qartësia që:

- Shkakton gufimin e njohjes (*ma'rifeh*)<sup>7</sup>
- Miraton gjetet<sup>8</sup>
- Jep mprehtësi<sup>9</sup>

---

në shkencat natyrore dhe shtrihet edhe në psikologji, antropologji, sociologji, politikë, etj.; krejt kjo ndërsa sheh njëmendësinë e dijes së shpallur.

<sup>3</sup> Mësimet e fesë vijnë nga një burim i sigurt, i pagabueshëm. Ndjekja e tyre çon në përfundimin e dëshiruar, kështu që, ata që i ndjekin, s'kanë pse të frikësohen a të shqetësohen. Ata duhet t'i gëzohen dëgjueshmërisë së tyre dhe t'i ruajnë me zell kufijtë hyjnor.

<sup>4</sup> Krejt çfarë bën Ai, është manifestim i përsosurisë së Tij, i madhështisë së Tij, i hijeshisë së Tij, dhe i mëshirës së Tij. Kur ai udhëzon dikë, kjo bëhet me hirin e Tij; kur Ai devijon dikë, kjo bëhet me drejtësinë e Tij.

<sup>5</sup> Ai jep dhe nuk jep, cakton dhe shpërndan për qëllime që nuk janë krejtësisht të njohura për ne. Megjithatë, në të gjitha rastet, Ai është mëshirëplotë dhe i mirë.

<sup>6</sup> Kur Ai të tërheqë (të merr) në shërbimin të Tijin, ngaqë e do afërsinë tënde.

<sup>7</sup> *Ma'rifeh* është dija e brendshme, që ngjallë zemrën dhe i bën pemët e virtyteve të saj të japin fryte.

<sup>8</sup> Gjetet janë konceptet dhe mendimet që s'mund të shprehen gojarisht. *Besirah* (qartësia) do t'i kultivojë këto dhe do t'i ankorojë në zemër, në mënyrë që të mos veniten.

<sup>9</sup> *Firaaseh* diskutohet në kapitullin vijues.